



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:094249
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05754929

CAP.nr.1013/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, sh.a, në Prishtinë, Rr. “Bill Clinton”, kundër debitorit të ndjerë J.G nga P,,, i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm M.G.(bashkëshortja e të ndjerit), nga P,,, Rr. “,,,” nr.,,, për shkak të përmbarimit të dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur përmes përfaqësueses të autorizuar av.F.M.-S kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1559/18, të datës 24.01.2023, me datën **29.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË e palejueshme (paafatshme) ankesa debitorit të ndjerë J.G nga P..., i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm M.G, e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.1559/18, të datës 24.01.2023.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar PPP.nr.1559/18, të datës 24.01.2023, ka pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit J.G nga P..., i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm M.G, ashtu që ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.414/17 të datës 05.06.2017 në shumën prej 399.95€, dhe ka obliguar debitorin J.G, i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm M.G që kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, sh.a, në Prishtinë, në emër të borxhit t’ia paguajë shumën prej 65.80€, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij vendimi.

Kundër këtij aktvendimi jashtë afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të *konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, aktvendimin e ankimuar ta prishë dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje ose të njëjtin ta ndryshojë, ndërsa propozimin për përmbarrim ta hedhë poshtë si të pa bazë.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), gjeti se:

- *Ankesa e debitorit është e palejueshme (paafatshme).*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbarrimit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, sh.a, në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbarrim kundër debitorit të ndjerë J.G nga P..., i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm M.G, ndërsa përmbarruesi privat me urdhërin P.nr.414/17, të datës 05.06.2017, e ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit me ID nr.,, të datës 30.05.2017, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit t’ia paguaj, shumë të përgjithshme prej 465.75€, me kamatë prej 8%, të paraparë më gjërësisht si në dokumentin përmbarrimor.

Kundër urdhërit për përmbarrim debitori ka paraqitur prapësim. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas prapësimit të debitorit ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1559/18, të datës 24.01.2023, me të cilin e ka pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar pjesërisht urdhërin për përmbarrim P.nr.414/17, të datës 05.06.2017 në shumë prej 399.95€ dhe obligohet debitori në emër të borxhit t’ia paguaj shumë prej 65.80€.

Gjykata e Apelit pasi e shqyrtoi ankesën e debitorit gjeti së sipas dispozitës së nenit 186 par.2 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se *“Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*, ndërsa me dispozitën e nenit 196 të LPK-së, parashihet se *“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë, me aktvendim, po që së nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç parashihet me nenin 186”*. Ndërsa në nenin 17 të LPP-së parashihet se *“Në procedurën përmbarrimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po që se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*.

Në këtë rast, Gjykata e Apelit në kuptim të dispozitës së nenit 186 par.2 të LPK-së, gjeti së ankesa e paraqitur nga debitori është e paafatshme, pasi që me shikimin në fletë-dërgesën për dorëzim personal, vërtetoi faktin se debitori, aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, PPP.nr.1559/18, të datës 24.01.2023, e ka pranuar me datë 30.01.2023. Në anën tjetër, ankesa ndaj këtij urdhëri është dorëzuar në gjykatë, përkatësisht në Postë me datën 07.03.2023,

e cila shihet nga vula e pranimi të Postës, e vendosur në ankesë. *Ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë shkresë tjetër, përmes së cilës do të konfirmohej se ankesa është dorëzuar edhe në ndonjë mënyrë tjetër, siç parashihet në nenin 103 të LPK-së.*

Pasi që afati për ankesë kundër aktvendimit lidhur me prapësimin sipas dispozitës së nenit 77 par.2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), është (7) ditë nga dita e pranimi të aktvendimit, ku shprehimisht parashihet se “Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi”, i cili afat i është dhënë në udhëzimin juridik të aktvendimit të atakuar, atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej (7) ditësh. Kjo për faktin se në rastin konkret afati ka filluar të llogaritet nga data 31.01.2023 (dita e parë pas ditës së pranimi të aktvendimit), ndërsa kur llogariten 7 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 06.01.2023-ditë pune, ndërsa debitori ankesën e ka paraqitur me datë 07.01.2023, që rezulton se ankesa është paraqitur me vonesë prej një (1) dite.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se “Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”.

Nga sa u tha me sipër, Gjykata e Apelit, vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që gjeti së ankesa e kreditorit është e paafatshme, të cilën kjo gjykatë e hudhi poshtë në pajtim me nenin 186 par. 2, 196 dhe 209 pika (a) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1013/23, datë 29.05.2024

Gjyqtari
Arsim Hamzaj